

VENDIM QARKULLUES

Nr. 54, datë 9.11.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR RAPORTIN E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 58, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe të nenit 60, pika 2, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 48, datë 31.7.2013, e ndryshuar, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në nenin 198/1, paragrafi ekzistues bëhet pika 1, si dhe shtohen pikat 2, 3 dhe 4 me përmbajtjen e mëposhtme:

“2. Përfshihet nga përcaktimi i nenit 12, pika 2, të kësaj rregulloreje, bankat ponderojnë me 0% titujt e borxhit të qeverisë shqiptare në monedhë të huaj, të emetuar gjatë vitit 2021.

3. Përfshihet nga përcaktimi i nenit 14, pika 1, të kësaj rregulloreje, bankat ponderojnë me 0% ekspozimet në formën e kredisë në monedhë të huaj të akorduar gjatë vitit 2021 ndaj Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., të garantuar plotësisht nga qeveria shqiptare.

4. Dispozitat e parashikuara në paragrafët 2 dhe 3, të këtij neni, do të zbatohen deri në maturimin e këtyre ekspozimeve.”

2. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gent Sejko